



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 581/1 Prot.

Fier, më 08/02/2021

V E N D I M N r . 2 8

Sot, më datë 08/02/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova materialin e plotë (bashkëngjitur), i mbajtur në ngarkim të subjektit “**PRODHIM FIER**” sh.p.k, me NIPT L92705402S, me seli në Fier (Lagjja “Konferenca e Pezës”, Pallatet Mërtiri Tragjase), me përfaqësues ligjor z. Genci Xhafa,

K O N S T A T O V A S E :

Në zbatim të legjislacionit doganor, Dega e Doganës Fier ka proceduar me kontrollin e zbatueshmërisë së Udhëzimit nr.4, datë 28/03/2019, kontrolli i operatorëve ekonomik që operojnë me RPA për periudhën kohore 2019-2020”.

Në vijim të administrimit të të dhënave dhe kontrollit të zbatueshmërisë ligjore nga ana e operatorit ekonomik “**PRODHIM FIER**” sh.p.k, me NIPT L92705402S, nga ana e Grupit të Kontrollit është konstatuar se për regjimin e përpunimit aktiv Nr.5892/1, datë 19.03.2019, nuk është paguar taksa doganore preferenciale për shumën 8.356 lekë.

Më tej, nga ana e Grupit të Kontrollit, u mbajt Proces-verbali i konstatimit (verifikimit të kundërvajtjes administrative) nr.2744/2 Prot., datë 11/01/2021, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën Nr.581 Prot., datë 05/02/2021, me lëndë “Njoftim i proces – verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative”. Në përfundim, pas shqyrtimit të plotë të materialit të mësipërm dhe të praktikës doganore, rezulton e provuar se nga ana e subjektit “**PRODHIM FIER**” sh.p.k, me NIPT L92705402S, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në dispozitat e legjislacionit doganor.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 49, 251/1, 251/2/a, 256/1/a, 261, 273, 276, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH”, Ligjin Nr.9590, datë 27.07.2006, V.K.M-në nr.651, datë 10.11.2017 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Ligjit nr.102/2014, datë 31/07/2014”, Manualit të Udhëzimit Nr.5, datë 31.03.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave,

VENDOSA :

- Subjekti “PRODHIM FIER” sh.p.k, me NIPT L92705402S, të paguajë detyrimin doganor në shumën **8,356** (Tetëmijë e treqindpesëdhjetegjashtë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Të dënoj me gjobë subjektin “PRODHIM FIER” sh.p.k, me NIPT L92705402S, në masën e njëfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 8,356 (Tetëmijë e treqindpesëdhjetegjashtë) lekë, bazuar në nenin 256/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e tyre.
- Kundër këtij vendimi, subjekti kundërvajtës “PRODHIM FIER” sh.p.k, me NIPT L92705402S, me seli në Fier, i lejohet të ushtrojë *ankim të arsyetuar* brenda afatit kohor 30 (*tridhjetë*) ditor nga marrja *dijeni e këtij vendimi*, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), si dhe garantuar paraprakisht 100% penalitetin, në zbatim të nenit 282 të Ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. Garantimi i penalitetit doganor duhet të kryhet vetëm nga bankat e nivelit të dytë dhe formati i kësaj Garancie Bankare duhet të kryhet në përputhje me formatin e Aneksit 80, shtojca B të V.K.M Nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”. Në të kundërt ankimi administrativ nuk do t’ju shqyrtohet”.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 582/1 Prot.

Fier, më 08/02/2021

V E N D I M N r . 2 9

Sot, më datë 08/02/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova materialin e plotë (bashkëngjitur), i mbajtur në ngarkim të subjektit “**PRODHIM FIER**” sh.p.k, me NIPT L92705402S, me seli në Fier (Lagjja “Konferenca e Pezës”, Pallatet Mërtiri Tragjase), me përfaqësues ligjor z. Genci Xhafa,

K O N S T A T O V A S E :

Në vijim të administrimit të të dhënave dhe kontrollit të zbatueshmërisë ligjore nga ana e operatorit ekonomik “**PRODHIM FIER**” sh.p.k, me NIPT L92705402S, nga ana e Grupit të Kontrollit është konstatuar se për regjimin e përpunimit aktiv Nr.5892/1, datë 19.03.2019, nga ana e subjektit është tejkualuar sasia e autorizuar.

Më tej, nga ana e Grupit të Kontrollit, u mbajt Proces-verbali i konstatimit (verifikimit të kundërvajtjes administrative) nr.2744/1 Prot., datë 05/01/2021, i cili i është njoftuar subjektit me shkresën Nr.582 Prot., datë 05/02/2021, me lëndë “Njoftim i proces – verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative”.

Në përfundim, pas shqyrtimit të plotë të materialit të mësipërm dhe të praktikës doganore, rezulton e provuar se nga ana e subjektit “**PRODHIM FIER**” sh.p.k, me NIPT L92705402S, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në dispozitat e legjislacionit doganor.


Për sa më sipër, mbështetur në nenet 49, 251/1, 251/2/a, 256/1/a, 261, 273, 276, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i RSH”, V.K.M-në nr.651, datë 10.11.2017 “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Ligjit nr.102/2014, datë 31/07/2014”, Manualit të Udhëzimit Nr.5, datë 31.03.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave,

V E N D O S A :

- Të dënoj me gjobë subjektin “**PRODHIM FIER**” sh.p.k, me NIPT L92705402S, në shumën 20,000 (Njëzetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/b të Kodit Doganor.

- Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e tyre.
- Kundër këtij vendimi, subjekti kundërvajtës “PRODHIM FIER” sh.p.k, me NIPT L92705402S, me seli në Fier, i lejohet të ushtrojë *ankim të arsyetuar* brenda afatit kohor 30 (tridhjetë) ditor nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke garantuar paraprakisht 100% penalitetin, në zbatim të nenit 282 të Ligjit 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. Garantimi i penalitetit doganor duhet të kryhet vetëm nga bankat e nivelit të dytë dhe formati i kësaj Garancie Bankare duhet të kryhet në përputhje me formatin e Aneksit 80, shtojca B të V.K.M Nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”. Në të kundërt ankimi administrativ nuk do t’ju shqyrtohet”.

KRYETAR
[Signature]
Olten Kuqe





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.5125/2 Prot.

Fier, më 08/02/2021

VENDIM Nr.31

Sot, më datë 08/02/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi mora në shqyrtim rekomandimin e lënë nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, ndaj subjektit “ARIS 04” sh.p.k me NIPT K52510402J, me seli në Fier (Lagjia “1 Maj”, Rruga “Nuredin Aliu”), me status në QKB “aktiv”, si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces verbalit të kontrollit aposterior nr.5125 Prot., datë 11/11/2020, i mbajtur nga ana e Grupit të Kontrollit

KONSTATOVA SE:

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, është dërguar shkresa me Nr.1229/6 Prot., date 05/08/2020, protokolluar me Tonën me nr.3669, date 13/08/2020, me lëndë “Dërgohet Raporti Final i Auditimit dhe Plani i Veprimit”.

Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, u hartua “Plani i Punës”, duke parashikuar në të masat dhe personelin doganor përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e detyrave të lëna në raportin final të auditimit.

Më tej, nga ana e Grupit të Punës u procedua me shqyrtimin e rekomandimit të lënë ndaj subjektit ARIS 04” sh.p.k me NIPT K52510402J.

Në kontrollin dhe verifikimin aposterior të kryer mbi deklaratën doganore IM.4 R 11157, datë 28/09/2019, për artikullin “Bojë hidromat për lyerje”, është proceduar me rivlerësimin doganor, bazuar në të dhënat e disponueshme me origjinë EU.

Subjekti ARIS 04” sh.p.k me NIPT K52510402J, është njoftuar nga Dega e Doganës Fier me anë të shkresës Nr.5125/1 Prot., datë 12.11.2020 me lëndë “Njoftim i Proces verbalit të verifikimit të kontrollit” dhe rezulton nga shërbimi postar (Lajmërim marrje me kod bar RR 413 296 438 AA) se keni marrë dijeni për këtë njoftim më datë 17-11-2020.

Për sa më lart, mbështetur në kreun III "Vlera për qëllime doganore" neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 "Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore" të Ministrit të Financave,

V E N D O S A :

- Subjekti ARIS 04" sh.p.k me NIPT K52510402J, të paguajë detyrimin doganor në shumën **60.243** (Gjashtëdhjetë mijë e dyqindëdyzetetë) lekë.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Sektori i Mbikqyrjes Doganore të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjekti ARIS 04" sh.p.k me NIPT K52510402J, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER**

Nr.5126/2 Prot.

Fier, më 08/02/2021

VENDIM Nr.32

Sot, më datë 08/02/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi mora në shqyrtim rekomandimin e lënë nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, ndaj subjektit “ECO MAT” sh.p.k me NIPT L42627403N, me seli në Fier (Lagjia “8 Shkurti”, Rruga "Skënderbeu", pallati jeshil, kati i pare, 100 m nga shkolla 9-vjeçare “Kristaq Shtëmbari”, në aks me unazën e re të qytetit), me status në QKB “aktiv”, si dhe pas marrjes në shqyrtim të Proces verbalit të kontrollit aposterior nr.5126 Prot., datë 11/11/2020, i mbajtur nga ana e Grupit të Kontrollit

KONSTATOVA SE:

Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, është dërguar shkresa me Nr.1229/6 Prot., date 05/08/2020, protokolluar me Tonën me nr.3669, date 13/08/2020, me lëndë “Dërgohet Raporti Final i Auditimit dhe Plani i Veprimit”.

Bazuar në këtë Raport Final, si dhe bazuar në legjislacionin doganor, pas një studimi të hollësishëm të tij, u hartua “Plani i Punës”, duke parashikuar në të masat dhe personelin doganor përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e detyrave të lëna në raportin final të auditimit.

Më tej, nga ana e Grupit të Punës u procedua me shqyrtimin e rekomandimit të lënë ndaj subjektit “ECO MAT” sh.p.k me NIPT L42627403N.

Në kontrollin dhe verifikimin aposterior të kryer mbi deklaratën doganore IM.4 R 4226, datë 28/05/2018; R 9401, datë 28/09/2018; R 4269, datë 20/04/2019; për artikullin “Bojë hidromat për lyerje”, është proceduar me rivlerësimin doganor, bazuar në të dhënat e disponueshme me origjinë EU.

Subjekti “ECO MAT” sh.p.k me NIPT L42627403N, është njoftuar nga Dega e Doganës Fier me anë të shkresës Nr.5126/1 Prot., datë 12.11.2020 me lëndë “Njoftim i Proces verbalit të verifikimit të kontrollit” dhe rezulton nga shërbimi postar (Lajmërim marrje me kod bar RR 417 351 801 AA) se keni marrë dijeni për këtë njoftim më datë 17-11-2020.

Për sa më lart, mbështetur në kreun III "Vlera për qëllime doganore" neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" (i ndryshuar),V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 "Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore" të Ministrit të Financave,

V E N D O S A :

- Subjekti "ECO MAT" sh.p.k me NIPT L42627403N, të paguajë detyrimin doganor në shumën **191.539** (Njëqindnëntëdhjetenjë mijë e pesëqindetridhjetenëntë) lekë.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Sektori i Mbikqyrjes Doganore të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjekti "ECO MAT" sh.p.k me NIPT L42627403N, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 "*Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë*".



Në përfundim, pas shqyrtimit të plotë të materialit të mësipërm dhe të praktikës doganore, rezulton e provuar se nga ana e subjektit "DINE GROUP" sh.p.k, me NIPT L73307405R, është kryer shkelja doganore - kundërvajtje administrative, shkelje kjo e parashikuar në dispozitat e legjislacionit doganor.

Për sa më sipër, mbështetur në nenet 49, 251/1, 251/2/a, 256/1/a, 261, 273, 276, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i RSH", Ligjin Nr.9590, datë 27.07.2006, V.K.M-në nr.651, datë 10.11.2017 "Për miratimin e dispozitave zbatuese të Ligjit nr.102/2014, datë 31/07/2014", Manualit të Udhëzimit Nr.5, datë 31.03.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave,

V E N D O S A :

- Subjekti "DINE GROUP" sh.p.k, me NIPT L73307405R, të paguajë detyrimin doganor në shumën **1,816,705** (Njëmilion e tetëqindëgjashtëmbëdhjetëmijë e shtatëqindëpesë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor.
- Të dënoj me gjobë subjektin "DINE GROUP" sh.p.k, me NIPT L73307405R, në shumën **20,000** (Njëzetëmijë) lekë, bazuar në nenin 256/1/a të Kodit Doganor.
- Subjekti "DINE GROUP" sh.p.k, me NIPT L73307405R, të paguajë kamatë vonesën e lindur në shumën **42,292** (Dyzetëdhjetë e dyqindëntëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 107 të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës dhe e Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e tyre.
- Kundër këtij vendimi, subjekti kundërvajtës "DINE GROUP" sh.p.k, me NIPT L73307405R, me seli në Fier, i lejohet të ushtrojë *ankim të arsytuar brenda afatit kohor 30 (tridhjetë) ditor nga marrja dijeni e këtij vendimi*, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke duke parapaguar 100 % detyrimin doganor dhe kamatë vonesën e lindur, si dhe garantuar paraprakisht 100% penalitetin, në zbatim të nenit 282 të të Ligjit 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë". Garantimi i penalitetit doganor duhet të kryhet vetëm nga bankat e nivelit të dytë dhe formati i kësaj Garancie Bankare duhet të kryhet në përputhje me formatin e Aneksit 80, shtojca B të V.K.M Nr.651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor". Në të kundërt ankimi administrativ nuk do t'ju shqyrtohet".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr.5725/4 Prot.

Fier, më 25/02/2021

VENDIM Nr.45

Sot, më datë 25/02/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi mora në shqyrtim Proces verbalin e kontrollit aposterior me nr.5725/3 Prot., datë 25/02/2021 (Për mallin e deklaruar me DAV nr R 10094, datë 16/12/2020, i mbajtur nga ana e Grupit të Kontrollit pranë Degës së Doganës Fier, ndaj subjektit "FERDINANT DUSHI" p.f, me NIPT K34308404L, me ushtrim të aktivitetit në Lushnjë (Savër, autostrada Lushnjë – Fier, kilometri i parë),

KONSTATOVA SE:

Më datën 16/12/2020, pranë Degës së Doganës Fier, është paraqitur subjekti "FERDINANT DUSHI" p.f, me NIPT K34308404L, me ushtrim të aktivitetit në Lushnjë, i përfaqësuar nga agjensia doganore "Best Choice", me kod J 100, për të deklaruar vendosjen në qarkullim të lirë të mallit, me deklaratën doganore IMP- 4 me numër R 10094.

Në zbatim të legjislacionit doganor si dhe Udhëzimit nr.05, datë 26.01.2018 "Mbi procedurat standarte të funksionimit të sektorit të vlerësimit qëndror dhe sektorit të kontrollit operativ", nga ana e SKAO (Sektorit të Kontrollit Aposterior Operativ – Aposteriori 5 ditor) në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, është proceduar me kontrollin dhe shqyrtimin e vlerësimit doganor, në përfundim të të cilit, kanë mbajtur Formularin mbi rivlerësimin doganor, sipas të cilit është atakuar metoda e vlerësimit doganor të praktikës doganore me R 10094, datë 16.12.2020, me argumentimet si vijon : Gjatë kontrollit dokumentar, u vu re se çmimi i deklaruar për produktin është më i ulët se të dhënat e disponueshme për të njëjtin tip mjeti, vit prodhimi, fuqi motorrike, ku u procedua si më lart (13500 euro x 80%).

Subjekti "FERDINANT DUSHI" p.f, me NIPT K34308404L, është njoftuar nga Dega e Doganës Fier me anë të shkresës Nr.5725/1 Prot., datë 28.12.2020 me lëndë "Njoftim Formulari Mbi Vlerësimin Doganor R 10094 dt.16.12.2020" dhe rezulton se nga ana e subjektit është administruar në sekretarinë e

Degës së Doganës Fier shkresa nr.5725/2 Prot., datë 21/01/2021, me lëndë “Kthim përgjigje”, me të cilën ka parashtruar si vijon “...Subjekti ka importuar kokë tërheqëse Scania R440 LA4X2 MLA e vitit 2009, me faturë blerje 5300 Euro, gjë e cila konfirmohet nga Proforma dhe Swifti banker. Gjithashtu po ne te njejtën date kam deklaruar dhe tre praktika me numer R 10089, R 10092, R 10093, koka tërheqëse mbi 10 vjet ku vlerësimi i këtyre tre praktikave nga ana e sektorit te vleres është bere me 850.000 leke. Duke mare dhe parasysh historikun qe kemi ne si subject per zhdoganimin e kokave terheqese te gjitha kokat qe kane qene vit prodhimi mbi 10 vjet jane marre me vleresimin 850.000 leke. Ne se nuk jemi dakort me vleresimin e bere nga Drejtoria e Vleres Tirane. Bashkangjitur Swifti dhe Proforma”.

Nga kontrolli aposterior i kryer, është llogaritur detyrimi doganor shtesë si vijon :

Nga verifikimi i deklaratës doganore IMP 4 me nr. R-10094 datë 28.12.2020 të subjektit “FERDINAND DUSHI” me Nipt K34308404L rezultoi se ka deklaruar Artikullin “KOKE TERHEQESE "SCANIA R 440 LA 4X2 MLA", VITI 2009,CIL 12740 CM3,ME NAFTE, E PERDORUR” me Kod Tarifor (NK) *87012090* me origjin nga Suedia. Nga ana e doganierit aposterior (5-ditor) është bere rivlersimi per kete artikull me 11.000 euro pasi dokumentat bashkëngjitur nuk e justifikojnë këtë trasaksion. Referuar shkreses nr.5725/1 prot, datë 21.01.2021 me lende “OBSERVACION” i subjektit “FERDINAND DUSHI” me Nipt K34308404L është e pasqyruar se Artikulli “Kokë Tërheqëse "Scania R 440 La 4x2 Mla", Viti 2009,Cil 12740 Cm3, me Naftë, e Perdorur” me Kod Tarifor (NK) *87012090* është i deklaruar me vleren e tij 5300 Euro. Referuar observacionit te operatorit ekonomik pasqyrohet se ky automjetet është i perdorur dhe është Vit Prodhim i Vitit 2009 kjo pasqyruar dhe ne lejen e qarkullimit.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.03 datë 23.01.2018 “Për rivlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, pika 17, pika 17.1, 17.2, 17.3 dhe 17.4 pasqyrojnë se Vlerësimi i automjeteve me vit prodhimi para vitit të fundit të publikuar në buletin, nuk mund të llogaritet më pak se çmimet e pasqyruara si më poshtë...”

Nga analiza e kryer dhe shqyrtimi i observacionit te operatorit ekonomik, pasqyrohet se dokumentat shoqëruese të operatorit ekonomik janë të pasakta dhe nuk disponon dokumentacion shtese per vertetimin e qellimit te funksionit te produktit. Gjithashtu, grupi i punes per nje vlersim sa me te drejte dhe reale është bazuar dhe ne DATA-BASE KOMBETAR TE VLERSIMIT ku shikohet se per automjetet dhe kamionet per nje prodhim me te larte se 10 vite është bere vlersimi me baze me vlere 850.000 leke ne zbatim te Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.03 datë 23.01.2018 “Për rivlerësimin e mallrave për

qëllime doganore”, pika 17, pika 17.1, 17.2, 17.3 dhe 17.4. dhe si deklaratat doganore IM 4 me R-81393 dt.17.09.2020 D.D.Durres, R-9417 dt.30.01.2021 D.D.Durres, R-17459 dt.18.02.2021 D.D.Durres, R-122326 dt.21.12.2020 D.D.Durres, R-10092 dt.16.12.2020 D.D.Fier i njejt operator ekonomik, R-75280 dt.28.09.2020 D.D.Tirane etj. Gjithashtu, në proces verbalin e kontrollit aposterior, është paraqitur dhe tabela e plotë e Data-Base Kombetar të Zhdoganimit.

Në këto kushte, obeservacioni i operatorit ekonomik është i paplotë dhe ne zbatim të Ligjit Nr. 102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, V.K.M-se nr. 651/2017 “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit nr. 104/2014” dhe Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.03 datë 23.01.2018 “Për rivlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, deklaruesi duhet të paraqesë dokumentacionin tregtar të mallit ku përfshihen të gjitha pagesat e bëra duke identifikuar shitësin dhe blerësin.

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.03 datë 23.01.2018 “Për rivlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, pika 6 përcaktohet se “Shqyrtimi i vlerës doganore bazohet në shqyrtimin e dokumentacionin shoqërues të DAV”:

- a) Fatura tregtare apo cdo document i barasvlershëm me të (për shembull, kontratë për blerje automjeti)
- b) Faturë transporti (kur transporti nuk përfshihet në faturën tregtare)
- c) Dokumentacioni i sigurimit të mallit (nëse ka)
- d) Certifikata e cilësisë (ose dokumentacion tjetër të ngjashëm)
- e) Certifikata e origjinës

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur, i cili gjendet i skanuar në sistemin elektronik doganor Asycuda World dhe dokumentacionin e depozituar pranë Degës Doganore Fier, rezulton se është paraqitur “Fatura Komerciale, Proforma Invoice, Deklaratë Eksporti, Swift Bankar, etj”.

Ne keto kushte grupi i punes i ka propozuar Kryetarit të Deges se Doganes Fier per rrezimin pjesor te Formularit te Rivlersimit Doganor nga SKAO pasi nuk permban asnje nga saktesim te dhenash dhe vlersimi i bere nga SKAO eshte bere referuar “Internetit” dhe jo të dhënave të disponueshme nga

Autoriteti Doganor Shqiptare dhe jo krahasimit të te njetit produkte me te njeten Origjine, te njetin Kod Tarifor si dhe Njeiti Eksportues dhe te Vlersohet me baze vlersimi me 850.000 leke.

Për këtë arsye, duke u ndodhur në kushtet e plotësimit të kërkesave të nenit 49, Dega e Doganës Fier, procedoi me mbajtjen e shkresës Nr.5725/3 Prot., datë 25/02/2021, me lëndë “Proces Verbal i Kontrollit aposterior”.

Për sa më lart, mbështetur në kreun III “Vlera për qëllime doganore” neni 65 e vijues të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin 03, datë 23.01.2018 “Mbi procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore” të Ministrit të Financave,

V E N D O S A :

- Subjekti “FERDINANT DUSHI” p.f, me NIPT K34308404L, të paguajë detyrimin doganor në shumën **41.769** (Dyzetenjëmijë e shtatëqindëgjatëdhjetenëntë) lekë.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Kontrollit Aposterior të procedojë me rregullimin e situatës sipas pikës 1 të Vendimit.
- Kundër këtij vendimi, subjekti “FERDINANT DUSHI” p.f, me NIPT K34308404L i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor (kundrejt amendimit të deklaratës doganore), në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

K R Y E T A R

Oftion Kuke





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS FIER

Nr. 351/4 Prot.

Fier, më 17/02/2021

VENDIM Nr.42

Sot, më datë 17/02/2021, unë Kryetari i Degës së Doganës Fier, pasi shqyrtova materialin e plotë (bashkëngjitur), i mbajtur në ngarkim të subjektit “**DINE GROUP**” sh.p.k, me NIPT L73307405R, me seli në Fier (Lagjja “16 Prilli”, Rruga “Leon Rei”, ndërtesa nr.1524, katri 1, 2, 3, 4), me përfaqësues ligjor znj.Dojana Kasaj,

K O N S T A T O V A S E :

Në zbatim të legjislacionit doganor, Dega e Doganës Fier ka hartuar programin e punës Nr.351 Prot., datë 25/01/2021, me tematikë “Verifikimi i stokut fizik dhe kontabël, marrje mostrash, verifikimi dokumentar sipas përcaktimit të Udhëzimit nr.4, datë 28/03/2019, që lidhet me regjimin 25067/1 datë 28.11.2018 (RPA) të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

Nga ana e grupit të kontrollit është administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Fier, shkresa me Nr.351/1 Prot., datë 26/01/2021, me lëndë “Informacion”, me të cilin kanë parashtruar si vijon : “Bazuar në programin e punës me nr.351 prot., datë 25.01.2021, grupi i punës i përbërë nga doganierët e mbikqyrjes doganore vajti për të ushtruar kontroll në ambientet e operatorit ekonomik “Dine Group” sh.p.k me Nipt L73307405R, me autorizim të përpunimit aktiv nr.25067/1 datë 28.11.2018. Në momentin e kontrollit, ky operator ishte i mbyllur dhe nuk ushtronte aktivitet.

Në vijim të administrimit të të dhënave dhe kontrollit të zbatueshmërisë ligjore nga ana e operatorit ekonomik “DINE GROUP” sh.p.k, me NIPT L73307405R, nga ana e Grupit të Kontrollit është konstatuar se për regjimin e përpunimit aktiv për autorizimin me nr.25067/1 datë 28/11/2018, nga ana e subjektit me deklaratën doganore R 6198, datë 11.06.2019, është kryer transferimi në këtë autorizim (5151) dhe më tej, nuk është kryer asnjë veprim, duke mos i dhënë destinacion doganor mallit.

Për këtë fakt, nga Dega e Doganës Fier është mbajtur shkresa Nr.351/2 Prot., datë 17/02/2021, me lëndë “Njoftim mbi detyrimet doganore”, në të cilën, subjektit i janë paraqitur konstatimet e kryera si dhe detyrimet doganore të lindura. Më tej, nga ana e Grupit të Kontrollit, u mbajt Proces-verbali i konstatimit (verifikimit të kundërvajtjes administrative) nr.351/3 Prot., datë 17/02/2021.